

PROJEKTMARREVESHJE

Mbi bashkimin me perthithje te shoqerise

“CROWN SECURITY SERVICES” SHPK nga

shoqeria ”LUFRA” SHPK

Bazuar ne ligjin nr 9901 date 14/04/2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare” i ndryshuar dhe ne zbatim te neneve 215 -224, lidhet kjo projekt-mareveshje midis perfaqesuesit ligjor te ”Crown Security Services” SHPK zotit Franc Ndreka dhe perfaqesuesit ligjor te ”Lufra” SHPK zotit Arben Ndreka, me objekt bashkimin me perthithje te ketyre subjekteve private. Nga diskutimet e ceshtjeve te ndryshme per bashkimin, kapitalet, punesimin dhe vazhdimin e funksionimit, etj. midis paleve u arriten keto konkluzione:

1. Shoqeria ”Lufra” SHPK me NIPT K33804402L e krijuar me vendimin nr 29364 date 26.03.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me seli ne Fier, njesia administrative Kolonje, fshati Bishqethem, lagjja Rruga e Kishes, Autostada Fier - Lushnje, zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632, do te jete shoqeria qe do te perthithe shoqerine “Crown Security Services” SHPK me nipt L73727401F e krijuar me date 27.01.2017, me seli ne Fier, njesia administrative Kolonje, Fshati Bishqethem, Lagjja Rruga e Kishes, Autostrada Fier - Lushnje zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632, nr 59, e cila ne kete rast do te jete shoqeria e perthithur.

2. Shoqeria ”Lufra” SHPK pranon te perthithe shoqerine “Crown Security Services” SHPK duke bashkuar pasurine e te dy subjekteve ne shoqerine ”Lufra” SHPK dhe ortaket do te marin aksione ne kembim te kapitalit qe ata zoterojne.

3. Shoqeria ”Lufra” SHPK eshte shoqeri qe ka nje kapital prej 23 760 000 leke dhe qe zoterohet nga zoti Arben Ndreka i cili pranon te kete marredhenie kembimi te kuotes me ortaket aktual te shoqerise “Crown Security Services” SHPK zotin Luis Ndreka e zotin Franc Ndreka, te cilet zoterojne secili nga nje kuote me vlere te njejte prej 2 000 000 leke.

4. Shoqeria perthithese ”Lufra” SHPK do te kete nje kapital prej 27 760 000 leke dhe i gjithje kapitali do te ndahet ne 3 kuota te cilat do te zoterohen nga:

Zoti Arben Ndreka do te kete 1 kuote me 85.6 % te kapitalit ose 23 760 000 leke

Zoti Franc Ndreka do te kete 1 kuote me 7.2 % te kapitalit ose 2 000 000 leke

Zoti Luis Ndreka do te kete 1 kuote me 7.2 % te kapitalit ose 2 000 000 leke

5. Shoqeria perthithese ”Lufra” SHPK i njeh si me siper te drejta te barabarta zoterinjve Franc Ndreka e Luis Ndreka te ardhur si ortaket e shoqerise “Crown Security Services” SHPK.

6. Pas bashkimit te te dy subjekteve mund te kete diskutime dhe ndryshime per sa i perket administratoreve te shoqerise se bashkuar apo emerimit te eksperteve kontabel qe do te bejne auditimin e pasqyrave financiare apo te problemeve te tjera .

7. Meqenese shoqeria “Crown Security Services” SHPK ka pezulluar aktivitetin e saj dhe nuk ka probleme me numer te madh punonjesish , shoqeria ”Lufra” SHPK mer persiper

detyrimet per te punesuar ata qe aktualisht jane te punesuar ne shoqerine "Crown Security Services" SHPK si dhe detyrimet qe mund te jene mbartur ndaj te gjithe punemarresve.

8. Shoqeria perthithese "Lufra" SHPK duke bere bashkimin e aktiveve e pasiveve te te dy shoqerive merr persiper te gjitha detyrimet ndaj te treteve qe kane mbetur per tu shlyer deri me 31.12.2018 e ne vazhdim nga ana e shoqerise "Crown Security Services" SHPK .

9. Perfaqesuesit ligjore te shoqerise "Lufra" SHPK dhe te shoqerise "Crown Security Services" SHPK mund te caktojne eksperte te pavarur te fushave te ndryshme per te vleresuar kushtet e projektmareveshjes se bashkimit. Ekspertet mund te caktohen nga secila shoqeri me vete apo edhe ne bashkepunim.

10. Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise se bashkuar ne perfundim te procesit te bashkimit nuk do te kete raport te vecante por do te raportohet se bashku me bashkimin. Nese shikohet e arsyeshme kapitali mund te rritet edhe nga rezervat aktuale te shoqerive.

11. Kjo projektmareveshje mund te prodhoje efekte vetem pasi te jete miratuar nga ortaku i vetem i shoqerise perthithese "Lufra" SHPK . dhe nga ortaket e shoqerise "Crown Security Services" SHPK , pasi me pare te jete publikuar ne QKR.

Per shoqerine

"Crown Security Services" SHPK


Franc Ndreka
CROWN SECURITY SERVICES
L 73727401 F

Date 06.09.2019

Per shoqerine

"LUFRA" SHPK

Arben Ndreka



RAPORT

I AUDITUESIT LIGJOR

MBI OPERACIONIN E BASHKIMIT NEPERMJET PERTHITHJES SE

SHOQERISE " CROWN SECURITY SERVICES " SHPK NGA

SHOQERIA "LUFRA " SHPK

Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise " LUFRA „SHPK

**Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise "Crown Security
Services „SHPK**

Une Eleda Dhima, Audituese Ligjore me numer license profesionale 197 date 30.01.2009, me NIPT K93819401P anetare e Insitutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, bazuar ne kerkesat individuale te asamblese se ortakut te vetem te shoqerise " LUFRA „, SHPK. dhe te ortakeve te shoqerise " Crown Security Services „, SHPK depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), jam caktuar te kryej misionin e ekspertit te bashkimit me perthithje te shoqerive te sipercituara.

Misioni i ngarkuar eshte i perbashket per te dy shoqerite qe marin pjese ne bashkim me ane te perthithjes.

I. Informacion mbi shoqerite dhe kushtet financiare te operacionit te bashkimit te hartuara dhe te pranuar nga shoqerite pjesmarrese.

Drejtimi i shoqerive " LUFRA " SHPK. dhe " Crown Security Services „, SHPK kane hartuar se bashku projektin e bashkimit me perthithje te 2 shoqerive, duke vendosur e miratuar termat perfundimtare te projektit, si metoden e vleresimit, drejtimin e bashkimit, raportet e kembimit, aktivet dhe pasivet qe do te transferohen. Ky projekt eshte miratuar nga ortaku i vetem i shoqerise " LUFRA „, SHPK dhe nga



ortaket e shoqerise " Crown Security Services ,, SHPK dhe do te depozitohet ne qendren Kombetare te Rregjistrimit.

Sipas projektit te bashkimit, shoqerite pjesmarrese, motivet, qellimet, modalitetet dhe kushtet e bashkimit paraqiten si vijon:

Shoqerite pjesmarrese ne operacionin e bashkimit kane te dhenat e meposhteme:

Shoqeria perthithese:

Shoqeria " LUFRA" SHPK me NIPT K33804402L e krijuar me vendimin nr 29364 date 26.03.2003 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me seli ne Fier, njesia administrative Kolonje, fshati Bishqethem, lagjja Rruga e Kishes, Autostada Fier - Lushnje, zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632, do te jete shoqeria qe do te perthithe dhe ka aktivitet te saj grumbullim, perpunim e tregtim te bulmetit, qumesht,kos,djath e gjithë nenproduktet e tyre. Import-eksport.Hapje baxho.Tregtim makineri e pajisje.Transport te bulmetit e te nenprodukteve te tij. Grumbullim, prodhim, perpunim, stampim ne forma te ndryshme, te lendeve plastike e tregtim te tyre. Tregtim te kafsheve shtepiake. Mbareshtim gjedhi e prodhim qumeshti. Prodhim, perpunim, tregtim te perimeve dhe artikujve te ndryshem ushqimor, import-eksport

Kapitali i shoqerise "LUFRA" SHPK eshte 23 760 000 leke, eshte nje kuote qe i perket 100% ortakut te vetem zotit Arben Ndreka.

Shoqeria e perthithur:

Shoqeria "Crown Security Services" SHPK me nipt L73727401F e krijuar me date 27.01.2017, me seli ne Fier, njesia administrative Kolonje, Fshati Bishqethem, Lagjja Rruga e Kishes, Autostrada Fier - Lushnje zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632, nr 59, e cila ne kete rast do te jete shoqeria e perthithur. Kjo shoqeri eshte me aktivitet ne fushen e sherbimeve te kategorive I.3.A: Ruajtjen dhe sigurimin i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik ose juridik qe ushtrojne veprimtarine ne Republiken e Shqiperise. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te shtetasve vendas ose te huaj me qendrim ne Republiken e Shqiperise. Ruajtjen dhe sigurimin e veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike ne te gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise. Shoqeria "Crown Security Services" SHPK e ka kapitalin e regjistruar 4 000 000 leke, i perbere nga 2 kuota qe i perket 2 ortakeve zoti Franc Ndreka e zoti Luis Ndreka, secili nga 1 kuote me nga 50 % ose 2 000 000 leke.

Ne projektin e bashkimit eshte projektuar qe shoqeria " LUFRA" SHPK do te jete shoqeria perthithese si dhe perfituese e kontributeve dhe do te shenohet me poshte si shoqeria perfituese, kurse shoqeria "Crown Security Services" SHPK shoqeria e perthithur qe do te shenohet me poshte si shoqeri kontribuese.



Sipas projektit qellimi i bashkimit eshte grupimi i forcave dhe mjeteve per krijimin e produkteve te reja dhe i marketingut ne funksion te rritjes se perfitimeve ekonomike si dhe efektshmerise, menaxhimi me i mire i burimeve njezore dhe financiare si dhe perballimi i konkurrences.

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi, parashikohet qe shoqeria "Crown Security Services" SHPK do ti transferoje (kaloje) shoqerise "LUFRA" SHPK teresine e elementeve te aktivitetit dhe pasivitetit duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera pas dates 31.12.2018.

Grupet kryesore te ketyre aktiveve dhe pasiveve te shoqerive pjesmarrese ne bashkim, jane caktuar e vleresuar mbi bazen e vlerave kontabel (vlera e mbeshtetur ne pasurine) qe ato kane ne pasqyrat financiare te mbyllura me 31.12.2018.

Shoqeria "LUFRA" SHPK do te jete zoteruese e kontributit te shoqerise "Crown Security Services" SHPK ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Shoqeria "LUFRA" SHPK gezon frutet e kontributit duke filluar nga 01.01.2019 me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise "Crown Security Services" SHPK nga data 01.01.2019 e deri ne daten e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga shoqeria perthithese "LUFRA" SHPK dhe rregjistrimet perkatese kontabel do te merren ne librat e saj.

Llogarite qe jane perdorur per te percaktuar kushtet financiare te bashkimit jane hartuar duke ju referuar dates 31.12.2018 si per shoqerine "LUFRA" SHPK ashtu edhe per shoqerine "Crown Security Services" SHPK

Sipas vleresimeve te bera dhe gjykimeve, eshte rene dakort qe raporti i kembimit te pjeseve te kapitalit te jete: nje pjese e kapitalin themeltar te shoqerise perthithese te jete i barabarte me 1 kuote te kapitalit te shoqerise se perthithur "Crown Security Services" SHPK dhe nje pjese e kapitalit themeltar te shoqerise perthithese te jete e barabarte me 1 kuote te kapitalit te shoqerise "LUFRA" SHPK. Ky operacion bashkimi nuk permban as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

II. Bazat e opinionit, shqyrtimi dhe vleresimi i informacionit.

Referuar nenit 217 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" objektivat e misionit te ekspertit te bashkimit, eshte te verifikojte dhe jape opinionin nese :

- vlerat perkatese qe u jane dhene aksioneve te kapitalit te shoqerive qe marrin pjese ne operacionin e bashkimit jane percaktuar duke zbatuar metoda dhe kriteret e pershtateshme dhe a ka pasur veshiresi te vecanta ne vleresimin e tyre.

- raporti i kembimit te aksioneve eshte i drejte dhe i arsyeshem.



Per kryerjen e misionit dhe hartimin e ketij raporti bashkimi, une jam mbeshtetur ne dokumentat e meposhteme:

- Projektin e bashkimit me perthithje te shoqerise "Crown Security Services" SHPK me shoqerine "LUFRA" SHPK hartuar dhe nenshkruar nga drejtimi i shoqerive pjesmarrese.
- Pasqyrat financiare , te shoqerive pjesmarrese ne bashkim me 31.12.2018
- Ne dokumentet ligjore te shoqerive, akt themelimi, dhe statutin perkates.
- Ne aktet e hartuara nga asamblete e ortakeve te 2 shoqerive, per miratimin e pasqyrave financiare dhe te projektit te bashkimit.

Bazuar ne sa me siper si dhe ne metodat e njohura per vleresimet e bizneseve dhe ne ate te pranuar ne projektin e bashkimit qe eshte vlera kontabel (ose e bilancit) une krega verifikimet qe kam cmuar te nevojshme mbi bilancet kontabel te shoqerive dhe dokumentacionin mbeshtetes te tyre, per percaktimin e vleres ekonomike dhe vleren kontabel te kontributeve te seciles shoqeri pjesmarrese ne bashkim.

Ne vijim pasqyrohen aktivet, pasivet dhe aktivi neto i shoqerive qe eshte baze e raportit te kembimit.

Per shoqerine perthithese "LUFRA" SHPK me 31.12.2018

a) AKTIVE

- Mjete monetare	12 761 242
- Aktive te tjera afatshkurtra financiare	76 546 136
- Aktive afatgjata materiale	746 461 248
- Aktivete afatgjata jomateriale	0
Totali i Aktiveve	835 768 626

b) PASIVE

- Huat dhe detyrimet afatshkurtra	510 740 506
- Detyrimet Afatgjata	68 427 654
Totali i detyrimeve	579 168 160
- Kapitali	23 760 000
- Rezervat	152 164 273
- Fitimi vjetor.	80 676 193
Totali i kapitalit	256 600 466
Totali i pasivit	835 768 626

Oliver

Aktivi neto (a-b) = 256 600 466 leke

Provizione per humbje te priteshme nuk jane parashikuar.

Vlera kontabele kontributit = 256 600 466 leke nga e cila kapital 23 760 000 leke.

Per shoqerine e perthithur:

Shoqeria "Crown Security Services" SHPK

a) AKTIVE

-	Mjete monetare	59 065
-	Aktive te tjera afatshkurtra financiare	4 000 000
-	Aktive afatgjata materiale	0
-	Aktivitet afatgjata jomateriale	0
	Totali i Aktiveve	4 059 065

b) PASIVE

-	Huat dhe detyrimet afatshkurtra	51 750
-	Detyrimet Afatgjata	0
	Totali i detyrimeve	51 750
-	Kapitali	4 000 000
-	Rezervat	662 957
-	Fitimi vjetor.	- 655 642
	Totali i kapitalit	4 007 315
	Totali i pasivit	4 059 065

Aktivi neto (a-b) = 4 007 315 leke.

Provizione per humbjet e priteshme nuk jane parashikuar.

Vlera kontabel e kontributit 4 007 315 leke nga e cila kapitali i regjistruar eshte 4 000 000 leke

Shkup

Nga verifikimet rezulton se per te dy shoqerite vlera kontabel e kontributeve eshte bazuar ne bilancet kontabel te dates 31.12.2018 te cilat jane hartuar mbi parime te njejta kontabile dhe vleresuar me te njejten metode vleresimi te percaktuar ne projekt.

Per grupet e aktiveve dhe pasiveve mbeshteten ne inventare fizike dhe kontabel analitike dhe jane te perputhura me te dhenat sintetike te paraqitura me siper.

Ato do te jene baza e transferimit te pasurise se shoqerise perthithese me hyrjen ne fuqi te bashkimit.

Shoqeria "LUFRA" SHPK pranon te kryhet bashkimi i pasqyrave financiare te shoqerise me pasqyrat financiare te shoqerise "Crown Security Services" SHPK duke bere qe gjendja e aktivitet dhe e pasivitet te bilancit per shoqerine e bashkuar "LUFRA" SHPK te arrije ne ne 839 827 691 leke. Aktivi i bilancit perbehet nga aktivet afat shkurtra materiale 93 366 443 leke dhe aktivet afatgjata materiale 746 461 248 leke.

Edhe pasivi do te jete ne shumen 839 827 691 leke, pasivet afatshkurtra 510 792 256 leke, pasivet afatgjata ne shumen 68 727 654 leke (gjithsej detyrimet 579 219 910 leke) dhe nga kapitali se bashku me rezervat do te jete 260 607 781 leke. Keto jane zerat kryesor te pasqyrave me zera te hollesishem paraqiten ne pasqyrat e pozicionit financiar te bashkimit, te cilat do te jene pjese perberese e raportit te bashkimit me perthithje per te dy shoqerite.

Vleresimi i metodave te perdorura.

Praktika e vleresimit te bizneseve njih shumte metoda midis te cilave mund te permendim, vleresimi duke u nisur nga vlera e pasurise (vlera kontabel, vlera kontabel e korrigjuar, vlera e mundeshme e shitjes etj); vleresimi i nisur nga parashikimet e veprimtarise dhe rezultateve te ardheshme etj. Zgjedhja e seciles prej metodave te mesiperme eshte ne varesi te natyres ekonomike e operacionit dhe eshte e rendesishme qe te zbatohet ne menyre te njejte per te gjitha shoqerite pjesmarrese. Une mendoj se metoda e zgjedhur nga dy shoqerite Vlera kontabel(Vlera e bilancit) i pershtatet natyres se aktiveve qe shoqerite kane ne bilancet e tyre dhe arrihet percaktimi i nje vlere sa me perfaqesuese per secilen shoqeri.

Nga te dhenat e mesiperme rezulton se raportet e kembimit per shoqerine qe perthithet jane: nje pjese e kapitalin themeltar te shoqerise perthithese do te kembehet me 1 kuote te kapitalit te shoqerise se perthithur "Crown Security Services" SHPK dhe nje pjese e kapitalit themeltar te shoqerise perthithese do te kembehet me 1 kuote te kapitalit te shoqerise "LUFRA" SHPK

III.Konkluzion

Ne perfundim te verifikimeve te kryera konkludoj se:

- Vlerat qe u jane dhene aksioneve ne kapitalin e shoqerive qe marrin pjese ne kete operacion bashkimi me perthithje jane percaktuar duke zbatuar kriteret te pershtateshme.
- Vendimi per bashkimin e shoqerive eshte ne perputhje me ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



- Projekti i perdorur per realizimin e bashkimit eshte i rregullt.
- Raporti i kembimit eshte i sakte dhe i drejte.
- Operacioni i bashkimit nuk cenon barazine e aksionereve.

Nese operacioni i bashkimit realizohet sipas projektit te paraqitur, kapitalit te nenshkruar te shoqerise "LUFRA" SHPK prej 23 760 000 leke i shtohet edhe kapitali themeltar i shoqerise "Crown Security Services" SHPK qe perthithet per shumen 4 000 000 leke

Shuma e kapitalit ne total do te jete 27 760 000 (njezeteshtatemilioneshtateqindegjashtedhjetemije) leke

Vlera e zmadhimit te kapitalit nga shoqeria perthithese i pergjigjet raporteve te kembimit dhe pasurise qe transferohet.

Para fillimit te procedurave te bashkimit, kapitali themeltar i shoqerise perthithese "Lufra" SHPK eshte 23 760 000 leke leke i perbere nga 1 kuote qe i perket ortakut te vetem te shoqerise "LUFRA" SHPK zotit Arben Ndreka. Mbas realizimit te operacionit te planifikuar per bashkimin e shoqerive kapitali shtohet edhe me 4 000 000 leke qe i perkasin shoqerise "Crown Security Services" SHPK dhe behet 27 760 000 leke i cili do te jete i ndare ne 3 kuota qe i perkasin zoterinjve Arben Ndreka, Franc Ndreka e Luis Ndreka, te cilet zoterrojne nga nje kuote por ne vlera te ndryshme.

Ne perfundim:

Shoqeria perthithese "Lufra" SHPK do te kete nje kapital prej 27 760 000 leke dhe i gjithe kapitali do te ndahet ne 3 kuota te cilat do te zoterohen nga:

Zoti Arben Ndreka do te kete 1 kuote me 85.6 % te kapitalit ose 23 760 000 leke

Zoti Franc Ndreka do te kete 1 kuote me 7.2 % te kapitalit ose 2 000 000 leke

Zoti Luis Ndreka do te kete 1 kuote me 7.2 % te kapitalit ose 2 000 000 leke

Ky raport hartohet ne 4 kopje , secila shoqeri nga 1 kopje, 1 ne QKR .

Audituese Ligjore

Eleda Dhima

Date 07.09.2019



(Handwritten mark)

Emertimi dhe Forma ligjore	LUFRA shpk	(I bashkuar)
NIPT -i	K 33804402 L	
Adresa e Selise	Bishqethem	Lushnje
Data e krijimit	26.03.2003	
Nr. i Regjistrimit Tregetar	29364	
Veprimtaria Kryesore	Grumbullim dhe perpunim i qumshtit , tregtimi i qumshtit dhe nenprodukteve te tij.	

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2018

Pasqyra Financiare jane individuale
 Pasqyra Financiare jane te konsoliduara
 Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
 Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga

Deri


31.12.2018

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

07.09.2019


Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 2018

Nr	A K T I V E T	Shenimet	Lufra	Crown S.S.	Lufra i bashkuar
	Aktivët Afatshkurtra		89,307,378	4,059,065	93,366,443
	▶ Aktivët monetare	1	12,761,242	59,065	12,820,307
	1 Banka		12,006,352	0	12,006,352
	2 Arka		754,890	59,065	813,955
	▶ Investime	2	0	0	0
	1 Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit	2.1			0
	2 Aksionet e veta	2.2			0
	3 Të tjera Financiare	2.3			0
	▶ Të drejta të arkëtueshme	3	47,682,004	4,000,000	51,682,004
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	3.1	34,152,004		34,152,004
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3.2			0
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	3.3			0
	4 Të tjera	3.4	13,530,000		13,530,000
	5 Të drejta e detyrime ndaj ortakëve	3.5		4,000,000	4,000,000
	▶ Inventarët	4	28,864,132	0	28,864,132
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	4.1	10,590,194		10,590,194
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	4.2			0
	3 Produkte të gatshme	4.3	7,476,017		7,476,017
	4 Mallra	4.4	1,768,419		1,768,419
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	4.5			0
	6 AAGJM të mbajtura për shitje	4.6	9,029,502		9,029,502
	7 Parapagime për inventar	4.7			0
	▶ Shpenzime të shtyra	5	0		0
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	6			0
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		89,307,378	4,059,065	93,366,443
	Aktivët Afatgjata				0
	▶ Aktive financiare	7	0	0	0
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	7.1			0
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7.2			0
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa	7.3			0
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa	7.4			0
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	7.5			0
	▶ Aktivët materiale	8	746,461,248	0	746,461,248
	1 Toka dhe ndërtesa	8.1	186,714,974	0	186,714,974
	2 Impiante dhe makineri	8.2	522,701,209		522,701,209
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje + mj transporti	8.3	6,413,595		6,413,595
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8.4	30,631,470		30,631,470
	▶ Aktivët biologjike	9	0	0	0
	▶ Aktive jo materiale:	10	0	0	0
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta	10.1			0
	2 Emri i Mirë	10.2			0
	3 Parapagime për AAJM	10.3			0
	▶ Aktive tatimore të shtyra	11			0
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar	12			0
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		746,461,248	0	746,461,248
	AKTIVE TOTALE		835,768,626	4,059,065	839,827,691



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 2018

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenimet	Lufra	Crown S.S.	Lufra i bashkuar
	► Detyrime afatshkurtra:	13	510,740,506	51,750	510,792,256
1	Titujt e huamarrjes	13.1			0
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	13.2			0
3	Arkëtime në avancë për porosi	13.3			0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	496,719,380		496,719,380
5	Dëftesa të pagueshme	13.5			0
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	13.6			0
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interes	13.7			0
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoq	13.8	10,825,280	51,750	10,877,030
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	3,195,846		3,195,846
10	Të tjera të pagueshme	13.10			0
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	14			0
	► Të ardhura të shtyra	15			0
	► Provizione	16			0
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		510,740,506	51,750	510,792,256
					0
	► Detyrime afatgjata:	17	45,814,619	0	45,814,619
1	Titujt e huamarrjes	17.1	45,814,619		45,814,619
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	17.2			0
3	Arkëtimet në avancë për porosi	17.3			0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	17.4			0
5	Dëftesa të pagueshme	17.5			0
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	17.6			0
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interes	17.7			0
8	Të tjera të pagueshme	17.8			0
	► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	18			0
	► Të ardhura të shtyra	19	22,613,035		22,613,035
	► Provizione:	20	0	0	0
1	Provizione për pensionet	20.1			0
2	Provizione të tjera	20.2			0
	► Detyrime tatimore të shtyra	21			0
	Totali i Detyrimeve afatgjata		68,427,654	0	68,427,654
	DETYRIMET TOTALE		579,168,160	51,750	579,219,910
	► Kapitali dhe Rezervat	22			0
	► Kapitali i Nënshkruar	23	23,760,000	4,000,000	27,760,000
	► Primi i lidhur me kapitalin	24			0
	► Rezerva rivlerësimi	25			0
	► Rezerva të tjera	26	152,164,273	662,957	152,827,230
1	Rezerva ligjore	26.1	4,950,506		4,950,506
2	Rezerva statutore	26.2			0
3	Rezerva të tjera	26.3	147,213,767	662,957	147,876,724
	► Fitimi i pashpërndarë	27			0
	► Fitim / Humbja e Vitit	28	80,676,193	-655,642	80,020,551
	Totali i Kapitalit		256,600,466	4,007,315	260,607,781
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		835,768,626	4,059,065	839,827,691



RAPORT I SHOQERISE "CROWN SECURITY SERVICES" SHPK

Mbi bashkimin me perthithje te shoqerise "CROWN SECURITY SERVICES" Sh.P.K. nga shoqeria "LUFRA" SHPK

Bazuar ne ligjin nr 9901 date 14/04/2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" dhe ne zbatim te neneve 215 -224, hartohet ky raport i hollesishem nga perfaqesuesi ligjor i shoqerise "Crown Security Services" SHPK zoti Franc Ndreka me objekt bashkimin me perthithje te shoqerise "Crown Security Services" Sh.P.K. nga shoqeria "Lufra" SHPK. Ne zbatim te nenit 216 pika 2 e ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" dhe nisur nga problemet e ndryshme qe kane dale per bashkimin me perthithje te shoqerive, per kapitalet e seciles shoqeri, per sistemimin e punesimin e punemarresve te shoqerive, veshtiresite e vecanta te vleresimit e vazhdimin e funksionimit te shoqerise perthithese pas bashkimit, etj.


1. Shoqeria "Crown Security Services" SHPK me nipt L73727401F e krijuar me date 27.01.2017, me seli ne Fier, njesia administrative Kolonje, Fshati Bishqethem, Lagjja Rruga e Kishes, Autostrada Fier - Lushnje zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632, nr 59, do te jete shoqeria e perthithur nga shoqeria "LUFRA" SHPK me NIPT L33709406U e krijuar me 09.01.2013 me seli ne ne Fier, njesia administrative Kolonje, fshati Bishqethem, lagjja Rruga e Kishes, Autostada Fier - Lushnje, zona kadastrale nr 1197, pasuria nr 5632 qe do te jete shoqeria qe do te perthithe shoqerine "Crown Security Services" SHPK.

Qellimi i bashkimit eshte grupimi i forcave dhe mjeteve per krijimin e produkteve te reja dhe i marketingut ne funksion te rritjes se perfitimeve ekonomike si dhe efektshmerise, menaxhimi me i mire i burimeve njerezore dhe financiare si dhe perballimi i konkurrences.

2. Shoqeria "Crown Security Services" Sh.P.K. i pranon te perthithet nga shoqeria "LUFRA" SHPK duke bashkuar pasurine e te dy subjekteve ne shoqerine "LUFRA" SHPK dhe ortaket e shoqerise "Crown Security Services" Sh.P.K. zoti Franc Ndreka e zoti Luis Ndreka do te marin kuota ne kembim te kapitalit qe ata zoterojne. Gjithashtu shoqeria "LUFRA" SHPK pranon te mare persiper te gjitha detyrimet e mundeshme te shoqerise "Crown Security Services" Sh.P.K..

3. Shoqeria "Crown Security Services" Sh.P.K. pranon te kryhet bashkimi i pasqyrave financiare te shoqerise me pasqyrat financiare te shoqerise "LUFRA" SHPK duke bere qe gjendja e aktivitetit dhe e pasivitetit te bilancit te bashkuar per shoqerine "LUFRA" SHPK te arrije ne 839 827 691 leke nga te cilat aktive afatshkurtra materiale 93 366 443 leke dhe aktive afatgjata materiale 746 461 248 leke.

Pasivi do te jete i perbere nga pasiviteti afatshkurtra ne shumen 839 827 691 leke, pasiviteti afatshkurtra 510 792 256 afatgjata ne shumen 68 727 654 leke (gjithsej detyrimet 579 219 910 leke) dhe nga kapitali se bashku me rezervat do te jete 260 607 781 leke.



Keto jane zerat kryesor te pasqyrave, me zera te hollesishem do te jene pjese perberese e raportit te Audituesit Ligjor qe eshte caktuar per te bere veprimet e bashkimit me perthithje per te dy shoqerite.

4. Per pjesen e kapitalit te shoqerise sqarojme se shoqeria "LUFRA" SHPK eshte shoqeri qe ka nje kapital prej 23 760 000 leke dhe qe zoterohet nga z Arben Ndreka i cili pranon te kene maredhenie kembimi te kuotave me shoqerine "Crown Security Services" Sh.P.K. qe e ka kapitalin 4 000 000 leke.

5. Shoqeria perthithese "LUFRA" SHPK do te kete nje kapital prej 27 760 000 leke dhe do te perbehet nga 3 kuota te cilat do te zoterohen nga:

Zoti Arben Ndreka do te kete 1 kuote me 85.6 % te kapitalit ose 23 760 000 leke

